



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë –Ministarstvo Pravde –Ministry of Justice

UDHËZIM ADMINISTRATIV
MD-NR. 05/2024
PËR KUSHTET E PUNËS DHE KOMPENSIMIN NË RAST TË
PAAFTËSISË PËR PUNË PËR TË DËNUARIT¹

¹ Udhëzim Administrativ MD – Nr. 05/2024 për Kushtet e Punës dhe Kompensimin në rast të Paaftësisë për punë për të Dënuarit, i aprovuar nga Ministrija e Ministrisë së Drejtësisë me datë: 12.07.2024, me Vendim Nr.169/2024.

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 75 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me nenin 9 (paragrafi 2) të Rregullores (QRK) - Nr. 17/2024 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV
MD - NR. 05/2024
PËR KUSHTET E PUNËS DHE KOMPENSIMIN NË RAST TË PAAFTËSISË PËR
PUNË PËR TË DËNUARIT**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është të përcaktojë kushtet e punës për të dënuarin, masat mbrojtëse dhe masat e sigurisë në punë, përgjegjësinë e Institucionit Korrektuese për sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe kompensimin në rast të paaftësisë së shkaktuar në punë për të dënuarin.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet në të gjitha Institucionet Korrektuese dhe për të gjithë të dënuarit e angazhuar në punë brenda Institucioneve Korrektuese.

**Neni 3
Kushtet e punës në Institucionin Korrektues**

- Institucioni Korrektues në cilësi të punëdhënësit është përgjegjës të krijojë ambient të përshtatshëm, të sigurojë kushtet e nevojshme, si dhe mbrojtjen e shëndetit në ambientet e punës.
- Institucioni Korrektues është i detyruar që në vazhdimësi të bëjë vlerësimin e rreziqeve për secilin vend të punës, dhe në mungesë të kapaciteteve të brendshme për vlerësimin e rreziqeve mund të kërkojë angazhimin e ekspertëve të fushës përkatëse.
- Institucioni Korrektues është i obliguar të mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të dënuarit që ka pësuar lëndim në punë gjatë mbajtjes në Institucionet Korrektuese.
- Institucioni Korrektues udhëhiqet nga parimi i trajtimit të barabartë në marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë të dënuarit e punësuar.
- Institucioni Korrektues është i obliguar të organizojë dhe të ndërmerr masa të nevojshme për

siguri në punë, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- 5.1. parandalimin e rreziqeve në punë;
 - 5.2. sigurimin e informacionit relevant lidhur me punën;
 - 5.3. ofrimin e trajnimeve adekuate;
 - 5.4. mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve adekuate të nevojshme për punë.
6. Institucioni Korrektues pajisë të dënuarit me mjete mbrojtëse të parapara për mbrojtjen kundër ekspozimit të dëmtimeve dhe rreziqeve në punë.
7. Institucioni Korrektues duhet t'i ketë në dispozicion pajisjet për dhënien e ndihmës së parë.
8. Institucioni Korrektues obligohet që në rast të lëndimeve të cilat i shkaktohen të dënuarit gjatë punës t'i siguroj:
- 8.1. dhënien e ndihmës së parë;
 - 8.2. evakuimin e të dënuarit në mënyrën adekuate;
 - 8.3. organizimin e kontaktit me shërbimin përkatës;
 - 8.4. mbrojtjen kundër zjarrit;
 - 8.5. shpëtimin e të dënuarve në rast të rrezikut.
9. Institucioni Korrektues harton raportin e aksidentit në vendin e tij të punës si dhe informon dhe bashkëpunon me institucionet kompetente.
10. Në rast të paraqitjes së rrethanave të paparashikuara dhe të jashtëzakonshme (forca madhore), Institucioni Korrektues nuk mbanë përgjegjësi për lëndimet e të dënuarit në vendin e punës.
11. Institucioni Korrektues vë në dispozicion të të dënuarve udhëzimet e nevojshme apo shenjat e rrezikut me qëllim të parandalimit të rrezikut për çdo vend pune.

Neni 4

Obligimet e të dënuarit gjatë orarit të punës

1. I dënuari duhet që t'i përmbahet rregullave të nevojshme për siguri në punë dhe ambient të punës si dhe të kujdeset për sigurinë dhe shëndetin e tij.
2. I dënuari duhet që t'i shfrytëzojë në mënyrë të duhur mjetet mbrojtëse, t'i përdorë me kujdes dhe t'i mbanë ato në gjendje funksionale.
3. I dënuari duhet të përkujdeset për mbrojtjen dhe shëndetin e personave tjerë të ndikuar nga puna e tij.

4. I dënuari duhet që pajisjet dhe mjetet e punës t'i përdorë sipas udhëzimeve të përcaktuara dhe të informoj zyrtarin përgjegjës për ndonjë defekt teknik.

5. I dënuari duhet të respektoj detyrimet e përcaktuara nga punëdhënësi nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, në të kundërtën do të jetë përgjegjës për dëmet e shkaktuara.

Neni 5

Të drejtat e personit të dënuar të angazhuar në punë brenda Institucionit Korrektues

1. Personi i dënuar ka të drejtë në beneficione, në masa mbrojtëse dhe përkujdesje shëndetësore në punën e tij sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Për zhdëmtimin e të dënuarve kundër lëndimeve në punë, duke përfshirë edhe sëmundjen profesionale merren masa nën kushte jo më pak të favorshme nga ato që i parasheh Ligji i Punës.

Neni 6

Kompensimi në rast të paaftësisë së shkaktuar nga lëndimi në punë

1. Në rastet kur trajtimi shëndetësor për të dënuarit që ka pësuar lëndim në punë nuk mund të bëhet në institucionet publike shëndetësore, Drejtori i Institucionit Korrektues merr vendim për kompensimin e shpenzimeve të cilat janë krijuar për trajtimin shëndetësor të të dënuarit.

2. Institucioni Korrektues pas kompletimit të raporteve, lëndën e procedon për kompensim në Departamentin për Financa në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

3. Nëse pas vlerësimit të gjendjes shëndetësore konstatohet se i dënuar nuk është i aftë për vazhdimin e kryerjes së punës për shkak të lëndimit në punë, Institucioni Korrektues të dënuarit i kompenson pagën prej 100% deri në 90 ditë pune. Pas kalimit të periudhës me kompensim të pagës, i dënuari i cili nuk është i aftë për të vazhduar punën, me vendim të Drejtorit të Institucionit Korrektues lirohet na puna.

4. Dëmi i pësuar nga lëndimi i shkaktuar me qëllim nga i dënuari nuk kompensohet nga Institucioni Korrektues.

Neni 7

Zbatimi

Dispozitat e këtij Udhëzim Administrativ zbatohen përshtatshëmrisht edhe ndaj personave të paraburgosur të cilët mbahen në Institucionet Korrektuese.

Neni 8

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzim Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ MD-Nr.04/2015 për kushtet e punës dhe kompensimin në rast të paaftësisë së shkaktuar në punë për të dënuarit.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

12.07/2024